Gjithashtu do të kemi dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave e cila është e njëjtë për të tre vitete 2025-2026-2027 në vlerën 36,088 mijë lekë.

	VITI 2025	VITI 2026	VITI 2027
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar sektoriale	170,471	172,176	173,898
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale rritja e pagave	36,088	36,088	36,088

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT	Program	VITI 2025			VITI 2026			VITI 2027		
		SHPENZIME KORENTE	SHPENZIME KAPITALE	TOTALI	SHPENZIME KORENTE	SHPENZIME KAPITALE	TOTALI	SHPENZIME KORENTE	SHPENZIME KAPITALE	TOTALI
Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1110	160,142	22,561	182,703	161,708	25,510	187,218	163,291	25,000	188,291
Sherbimet Policore	3140	9,231	0	9,231	9,323	0	9,323	9,417	0	9,417
Strehimi	6190	3,000	0	3,000	3,000	0	3,000	3,000	0	3,000
Menaxhim i Infrastruktures se Ujitjes dhe kullimit	4240	2,150	18,000	20,150	2,172	20,000	22,172	2,193	20,000	22,193
Administrimi i Pyjeve dhe kullotave	4260	21,664	2,000	23,664	21,881	10,000	31,881	22,099	10,000	32,099
Rrjeti rrugor Rural	4520	53,204	153,134	206,338	53,736	173,386	227,122	54,273	168,683	222,956
Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuar (Qendra Ditore femijeve me AK)	10430	8,823	0	8,823	8,911	0	8,911	9,000	0	9,000
Sherbimet Publike	6260	49,500	0	49,500	49,995	0	49,995	50,495	0	50,495
Sherbimi pastrimit dhe transporti mbetjeve urbane	6260	32,000	0	32,000	32,000	0	32,000	32,500	0	32,500
Sport dhe argetim kulturore, evente artistike dhe kulturore	8130	16,000	0	16,000	16,000	0	16,000	16,000	0	16,000
Arsimi baze dhe parashkollor	9120	13,980	0	13,980	14,120	0	14,120	14,261	0	14,261
Arsimi Mesem i pergjithshem	9230	120,070	5,960	126,030	121,271	10,000	131,271	122,483	20,000	142,483
Furnizimi me uje	6370	3,040	9,337	12,377	3,070	0	3,070	3,101	0	3,101
Çerdhja e femijeve	10430	0	0	0	0	0	0	0	20,000	20,000
Menca Sociale	10430	18,290	0	18,290	18,473	0	18,473	18,658	0	18,658
Menaxhi i mbetjeve urbane	10430	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	5100	9,000	0	9,000	9,000	0	9,000	9,000	0	9,000
Fond rezerve	3280	21,781	0	21,781	21,999	0	21,999	22,219	0	22,219
Emergjencat Civile	4980	15,523	0	15,523	16,197	0	16,197	16,818	0	16,818
	3280	7,762	0	7,762	8,099	0	8,099	8,409	0	8,409
<b>Shuma I</b>		<b>565,160</b>	<b>210,992</b>	<b>776,152</b>	<b>570,954</b>	<b>238,896</b>	<b>809,850</b>	<b>577,217</b>	<b>263,683</b>	<b>840,900</b>

- Për vitin 2025 tavanet janë parashikuar 776,152 mijë lekë nga të cilat 27% i zënë investimet dhe 73 % janë shpenzime koherente(600-601-602-604-606).
- Për vitin 2026 tavanet janë parashikuar 809,850 mijë lekë nga të cilat 29 % i zënë investimet dhe 71 % janë shpenzime koherente(600-601-602-604-606).
- Për vitin 2027 tavanet janë parashikuar 840,900 mijë lekë nga të cilat 31 % i zënë investimet dhe 69 % janë shpenzime koherente(600-601-602-604-606).

### III. Programet dhe Tavanet


Sipas udhezimit Plotesues nr.3 date 28.02.2024 "Per pergatitjen e programii buxhetor afatmesem vendor 2025-2027", anekset plotesuese dhe shtojcat bashkangjitur ketij udhezimi struktura e programeve te buxhetit vendor Librazhd do te jete si me poshte:

Kodi i Programit	Emri i Programit
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi
03140	Shërbimet e Policisë Vendore
03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile
04240	Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit
04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave
04520	Rrjeti Rrugor Rural
05100	Menaxhimi i Mbetjeve
06260	Shërbimet Publike Vendore
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime
08130	Sport dhe Argëtim
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore
09120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin
09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm
10430	Përkujdesi Social
10661	Strehimi Social

P/Buxhetit  
Emanuela Çekrezi



D.Buxhetit dhe Finances  
Albana Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHDI

KRYETARI

P/VENDIM

NR \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/07/2024

“PER MIRATIMIN E PROJEKTIT TE PARE BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Udhëzimi nr.3 date 28.02.2024 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2025-2027”, Udhëzimi plotësues nr.8 datë 05.07.2024 “Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2025-2027”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/07/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratoje “Projektin e I-rë Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027” IPF për Bashkinë Librazhd sipas formateve bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Kryetari i Bashkisë**  
**Mariglen Disha**

**Bashkia Librazhd**

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM  
2025 - 2027**

**Faza e I Qershor**

## 1. HYRJE

### 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifave vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektiveve të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxheti që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART<sup>1</sup>. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë<sup>2</sup> (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare<sup>3</sup>, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

<sup>1</sup> Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

<sup>2</sup> 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

<sup>3</sup> Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësi vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart<sup>4</sup> i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave

<sup>4</sup> Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT).

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së



## 2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Librazhd

### 2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia jonë përfshin një territor me një sipërfaqe prej 794 km<sup>2</sup>, dhe një popullsi prej rreth 32,052 banorë të regjistruar. Bashkia Librazhd ka në përbërjen e saj 7 njësi administrative: Librazhd, Librazhd-Qenër, Hotolisht, Polis, Orenjë, Lunik, Steblevë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra.

Kjo bashki në pjesën më të madhe të territorit të saj, mbizotërohet nga reliev malor e kodrinor, e rrethuar nga malet e Shebenikut, të Çermenikës dhe Sopotit.

Bashkia Librazhd ndodhet në zonën ekonomike funksionale të qarkut Elbasan si dhe përshkohet nga elementë të rëndësishëm me karakter kombëtar. Këta janë elemente natyrore, gjeografik, infrastrukturë dhe bujqësor.

Vlen të përmendim që në territorin e Bashkisë Librazhd ndodhen zonat e mbrojtura si më poshtë:

1. Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë
2. Parku Natyror Rajonal Kutërman
3. Parku Natyror Rajonal Polis
4. Parku Natyror Rajonal Sopot
5. Parku Natyror Rajonal Dardhë-Xhyrë



Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Librazhd, Librazhd-Qenër, Hotolisht, Polis, Orenjë, Lunik, Steblevë. Njësia Administrative Qendër ka sipërfaqe më të madhe (197.56 km<sup>2</sup>), ndiqet më pas nga Njësia Administrative Hotolisht (175.26 km<sup>2</sup>), Njësia Administrative Steblvë (123.34 km<sup>2</sup>), Njësia Administrative Lunik (102.62 km<sup>2</sup>), Njësia Administrative Orenjë (101.88 km<sup>2</sup>), Bashkia Librazhd (1.86 km<sup>2</sup>).

Emri i Njesisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Librazhd	Qyteti Librazhd
Qendër Librazhd	Fshatrat; Librazhd Qëndër, Arrëz, Babje, Dorëz, Dragostunjë, Kuturman, Gizavesh, Librazhd Katund, Marinaj, Qarrishtë, Spathar, Togëz, Merqizë, Semes
Hotolisht	Fshatrat; Hotolisht, Dardhë, Vulçan, Buzgarë, Kokrevë, Vehçan, Xhyrë, Çerçan
Lunik	Fshatrat; Lunik, Prevall, Dranovicë, Kostenjë, Letëm, Zgosht, Koshorisht
Stëblevë	Fshatrat; Stëblevë, Zabzun, Borovë, Llangë, Sebisht, Moglicë, Prodan
Polis	Fshatrat; Polis, Mirakë, Gostimë, Sheh, Gurëshpatë, Vilan
Orenjë	Fshatrat; Orenjë, Floq, Gurakuq, Ballgjin, Rinas, Zdrajsh Verri, Zdrajsh, Neshtë, Mëxixë, Funarës

Bashkia Librazhd ka një popullsi të vogël e cila paraqitet mjaft “delikate” ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në zonë .

**Tabela 1 .Të dhëna mbi Bashkinë Librazhd**

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, Librazhdi ka një popullsi prej 32,052 banorësh. Ndërkohë që sipas regjistrimit civil ,kjo bashki numëron 44,181 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 794 km<sup>2</sup>. Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas censurit ,densiteti është 40 banorë/km<sup>2</sup>.

**Zona Gjeografike:** Librazhdi kufizohet në veri me bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë ,në jug me bashkinë Prrenjas dhe në perëndim me bashkitë Elbasan dhe Tiranë . Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Librazhdit.

**Zhvillimi ekonomik:** Bashkia Librazhd karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktivitetesh ekonomike ku mund të gjejmë elementë të bujqësisë ,industrisë, energjisë, zonave turistike dhe ekonomike. Vërehet se baza ekonomike përbëhet nga bizneset evogla, të cilat janë katalizatorë të zhvillimit,pasi krijimi,zhvillimi, dhe përmirësimi i këtyre bizneseve përben një potencial të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik.Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehtë prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile((fabrika e plasmasit,duhanit,fasoneri)si dhe tregti e biznese shërbimesh.Si një zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtoriale kemi prani të bizneseve agro-ushqimore të cilat tregtojnë produkte që prodhohen në rrethin e Librazhdit.

Një tjetër avantazh konkurues i bashkisë Librazhd si rrjedhojë e pozicionit të saj gjeografik është edhe zhvillimi i turizmit të shumëllojshëm dhe gjithë-vjetor. Kjo nënkupton zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik,zhvillimin e turizmit malor, zhvillimin e eko-turizmit etj.Në

zonën e Librazhdit ekziston një gamë e gjerë bukurish natyrore, që nga malet deri tek vija lumore e Shkumbinit, nga rrugët që përmenden dhe në histori për rolin e tyre si rruga Egnatia dhe deri tek kështjellat e vogla dhe monumente të tjera kulturore. Por ajo që e dallon dhe e karakterizon bashkinë Librazhd është se nën administrimin e saj ka Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë përbën një ndër pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm të bashkisë Librazhd. Paralelisht me resurset natyrore, zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit.

**Punësimi:** Për vitin 2023 rezulton se numri i të papunëve në Bashkinë Librazhd është 700 persona, nga të cilat 365 janë femra (të dhëna nga Zyra e Punës Librazhd).

## 2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë Librazhd

Burimi i Informationit: PPV / PZHS

Transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, qeverisja me pjesëmarrje, shërbesa me etikë dhe përgjegjshmëri, ndërhyrjet me efikasitet, përdorimi me efikasitet i fondeve, instrumentet e rinj të administrimit, përmes përdorimit të teknologjisë bashkohore, procedurave dhe rregullave që do të vijojmë të zhvillojmë, janë principet dhe mënyra e punës tonë.

## 3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Librazhd

### 3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Burimi i Informacionit: PPV / PZHS

Synimi jonë është kthimi i Bashkisë Librazhd në një qendër të rëndësishme kombëtare dhe një nyjë e rëndësishme transporti. Në përmbushje të këtij synimi Bashkia Librazhd do të fokusojë përpjekjet e saj në drejtim të garantimit të barazisë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve. Për këtë arsye programi buxhetor afatmesëm do të shërbejë përpjekjeve në vazhdim për të përmbushur vizionin e Strategjisë Territoriale për Zhvillimin 2015-2030 si më poshtë:

- Përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundësuar akses të plotë për të gjithë, përmes financimit me fonde të veta, aksesit në fondet qeveritare;
- Përmirësimin e menazhimit të shërbimeve publike: menazhim të mbetjeve, mbrojtjes së mjedisit, ndriçimit rrugor, furnizimit me ujë të pishëm, hapësirave të gjelbra, etj;
- Përmirësimin e lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë;

- Përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e territorit të Bashkisë Librazhd;
- Promovimin e produkteve vendore, nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Mbrojtja e mjedisit, parandalimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve;
- Projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirë administrimin e infrastrukturës së ndërtuar;
- Nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjëve në aktivitete sportive si aktorë thelbësor në zhvillimin e territorit;
- Ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të Bashkisë Librazhd;
- Sigurimin e ambjenteve dhe mjediseve të përshtatshme arsimore, të sigurt dhe drejt përmbushjes së standarteve ligjore;
- Krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminim për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit;
- Parandalimin e kundravajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe këshillit bashkiak;

Bashkia Librazhd është fokusuar në tre objektiva kryesorë:

**Objektivi A:**

- Zhvillimi social-ekonomik I infrastrukturës.  
Zhvillimi social –ekonomik dhe I infrastrukturave ka për qëllim që të vërë në qendër zhvillimin social –ekonomik të territorit duke e integruar me një zhvillim dhe fuqizim të infrastrukturave të ndryshme të rrjeteve teknologjike si parakusht për një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të territorit .

Objektivi A1:Fuqizimi i infrastrukturës lidhëse, rivitalizimi I transportit intermodal.

Objektivi A2:Promovimi i një sistemi inovativ dhe të larmishëm të prodhimit .

Objektivi A3:Promovimin e territorit si një destinacion turistik.

Objektivi A4:Përmirësimi i cilësisë së imazhit urban dhe territorit.

Objektivi A5:Përmirësimi i shërbimeve për njeriun.

**Objektivi B:**

- Organizimi hapësinor I bashkisë dhe rikualifikimi I imazhit urban.

Objektivi B1:Transformimi I territorit të Librazhdit ,në një territor të integruar multipolarmes qyteteve dhe fshatrave .

Objektivi B2:Promovimi i qytetit kompakt dhe përmirësimi I hapësirpublike.

Objektivi B3:Ribalancimi funksional përmes promovimit të karakteristikave lokale.  
Objektivi B4:Përmirësim arkitektonik I peizazhit dhe mjedisit ,I qendrave dhe tokave bujqësore dhe natyrore.

Objektivi C:

- Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit.

Objektivi C1:Reduktimi I ndotjes së ujit.  
Objektivi C2:Reduktimi dhe menaxhimi I mbetjeve.  
Objektivi C3:Reduktimi I ndotjes së ajrit.

Objektivi C4:Mbrojtja dhe përmirësimi I tokës dhe burimeve hidrogeologjike

### 3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit

Burimi i Informacinit: PPV

1. Mbrojtja dhe përdorimi racional i burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, peisazhin dhe mjedisin;
2. Një zhvillim i balancuar i zgjidhjeve, me theks të veçantë në aktivitetet ekonomike ekzistuese ose që zhvillohen brenda territorit të bashkisë;
3. Plotësimin e nevojave të strehimit në lidhje me shërbimet dhe objektet e komunitetit me interes të bashkisë, që të mund të arrihet kryesisht nëpërmjet rimëkëmbjes dhe plotësimit të zonave urbane dhe ndërtesave ekzistuese;
4. Ekuilibrin mes morfologjisë së territorit dhe ndërtesave, aftësia për zgjidhjen teorike e PPV dhe strukturës së shërbimeve.
5. Mbrojtjen dhe zhvillimin e tokës për qëllime ekonomike duke nxitur turizmin dhe bujqësinë.
6. Përdorimin e tokës ndërtimore brenda perimetrit të përcaktuar nga autoritetet . Rregullat e ndërtimit përcaktojnë përdorimet e lejeve, të ndaluara ose me kusht, përcaktimi i zonave / njësive për densifikimin, rigjenerimin, rehabilitimin, konservimin, urbanizimin si për zona të reja dhe të territoreve për programet e strehimit social, etj.
7. Krijimin e një hierarkie me dendësi më të lartë ndërtimore në zonat qendrore dhe më rrallë në drejtim të zonave të jashtme.
8. Mbrojtjen e tokës bujqësore dhe natyrore.

## 4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË LIBRAZHD 2025-2027

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Librazhd gjatë periudhës 2025-2027, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2025-2027, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet

2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia

#### 4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Librazhd në vitet 2025-2027

##### 4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Librazhd për vitet 2025-2027

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

**Buxheti total i Bashkisë Librazhd** për vitin 2024 është 910,329 *mijë lekë*, në vitin 2025 është planifikuar 776,153 *mijë leke*, ndersa ne vitin 2026 është planifikuar 809,850 *mijë lekë*, ndersa ne vitin 2027 është planifikuar 840,900 *mijë lekë*,

Financimi i buxhetit realizohet nga:


- **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera .
- **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë, transfertat specifike.

#### Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Librazhd

		2025	2026	2027
		Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
<b>A</b>	<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>	177,420	187,559	191,310
A.1	TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	35,407	41,324	42,151
A.2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)	25,575	25,977	26,496
A.3	TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	104,336	105,951	108,070
A.4	TË ARDHURAT E TJERA	14,102	14,307	14,593
<b>B</b>	<b>TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR</b>	596,733	622,291	649,590
B.1	Transferta e pakushtëzuar	390,173	414,027	439,604
B.2	Transferta e kushtëzuar	-	-	-
B.2.1	Për funksionet e deleguara	-	-	-
B.2.2	Për projekte të veçanta	-	-	-


B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	206,560	208,264	209,986
	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE (A+B)</b>	<b>776,153</b>	<b>809,850</b>	<b>840,900</b>

Grafik 1 Burimet e Financimit të PBA 2025 - 2027



Të ardhurat nga burimet qendrore, rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore.

Grafik 2 Raporti i burimeve të financimit 2025-2027



#### 4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ndarja e transfertës së pakushtëzuar sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për periudhën 2025-2027, është bërë bazuar në formulë, sipas përcaktimeve të nenit 24 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Të dhënat sipas kriterit të popullsisë, të dëndësisë së popullsisë, të numrit të nxënësve, taksat e përdorura për ekualizimin janë ato të përdorura në ndarjen e transfertës së pakushtëzuar në buxhetin e vitit 2024.

Sipas udhëzimit nr. 3 datë 28.02.2024“ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” ;

Vitet	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
Transferte e pakushtëzuar	368,755	390,173	414,027	439,604

Transferta e pakushtëzuar është rritur me rreth 4 % nga viti në vit.

#### 4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Sipas udhëzimit transferta e pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor për periudhën 2025-2027, bazohet në kuadrin makroekonomik e fiskal të miratuar.

Ndarja e transfertës pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2025-2027 do të jetë sipas tabelës se mëposhtme :

Vitet	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
Transferte e pakushtëzuar sektoriale	190,519	206,560	208,264	209,986

Transferta e pakushtëzuar sektoriale është rritur me 1 % nga viti në vit.



## 2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Librazhd për periudhën 2025-2027

KOD I	EMËRTIMI LLOGARISË	FAK TI 2022	FAK TI 2023	FILLEST AR2024	RISHIKU AR2024	PLAN 12025	PLAN 12026	PLAN 12027
	<b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>	<b>262,800</b>	<b>307,990</b>	<b>393,176</b>	<b>394,923</b>	<b>369,490</b>	<b>373,185</b>	<b>376,917</b>
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	225,343	264,154	340,274	341,846	318,725	321,912	325,132
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	37,457	43,836	52,902	53,077	50,765	51,273	51,785
	<b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)</b>	<b>158,634</b>	<b>149,544</b>	<b>227,610</b>	<b>224,173</b>	<b>195,670</b>	<b>197,769</b>	<b>200,300</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera	132,298	124,850	181,647	184,239	149,885	150,973	152,572
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	13,818	14,001	16,000	20,815	18,000	18,000	18,000
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferita per buxhetet familiare dhe individet	12,518	10,693	13,268	13,268	12,262	12,599	12,905
609	Rezervat	0	0	16,695	5,851	15,523	16,197	16,818
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)</b>	<b>92,828</b>	<b>282,081</b>	<b>289,543</b>	<b>298,568</b>	<b>210,993</b>	<b>238,896</b>	<b>263,682</b>
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	5,402	16,055	16,055	5,000	5,000	5,000
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	92,828	276,679	273,488	282,513	205,993	233,896	258,682
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0

255	Te dala per hua-dhënie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>TOT ALI</b>	<b>514,262</b>	<b>739,615</b>	<b>910,329</b>	<b>917,664</b>	<b>776,153</b>	<b>809,850</b>	<b>840,900</b>			

#### 4. REKOMANDIMET

❖ Mbi rekomandimet e lëna për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 nga Ministria e Financave dhe ekonomisë me shkresën nr.8592 prot datë 19.06.2024.

1. Të rritet pesha që investimet zënë në buxhetin e bashkisë .

Rritja e peshës që zënë investimet në buxhet në raport me shpenzimet e tjera është një çështje e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe menaxhimin fiskal të një vendi. Kjo rritje kërkon një qasje të balancuar që merr në konsideratë nevojat urgjente dhe të gjata të ekonomisë dhe shoqërisë. Nga ana e bashkisë Librazhd është bërë e mundur rritja e peshës së investimeve nga viti në vit.

2. Të identifikohet stoku i detyrimeve, të hartohet dhe të ndiqet me përpikmëri plani për shlyerjen e detyrimeve .

Gjatë plotësimit të fazës së I-rë të PBA-së bashkia Librazhd në fillim të vitit 2024 ka deklaruar detyrime të palikujduara në vlerën 2,035 mijë lekë dërguar edhe me shkresë zyrtare nr.485 prot datë 26.01.2024 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

P/Buxhetit

Emanuela Çekrezi



D/Buxhetit dhe Financës

Albana Hoxha



Punoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHË

KRYETARI

P/VENDIM

NR \_\_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/07/2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B NR.119 DATË 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin nr. 22 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore” ,Udhëzimi plotësues nr.1 date 24.01.2024 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/07/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratoj financimin e TVSH –së për blerje kamion zjarrfikës Librazhd Projekti për Sigurimin e një kamioni zjarrfikës në Librazhd në vlerën 1,446,487 lekë.
2. Të miratoj shtesë fondi për mbikqyrje-kolaudime për vitin 2024 në vlerën 2,000,000 lekë.
3. Të miratojë shtesë fondi për ndihmë financiare për familje në vështirësi financiare në vlerën 500,000 lekë.
4. Të miratojë shtesë fondi për shpenzime ujë dhe drita për programin rrugët rurale në vlerën 150,000 lekë .
5. Të miratojë shtesë fondi për shpenzime ujë dhe drita për programin Qendra ditore me aftësi të kufizuar në vlerën 200,000 lekë .
6. Të miratojë shtesë fondi për udhëtime e dita brenda vendit në vlerën 200,000 lekë dhe udhëtime e dieta jashtë vendit në vlerën 300,000 lekë.

7. Të miratojë shtesë fondi rezervë në vlerën 3,563,513 lekë.
8. Për sigurimin e këtyre fondeve të miratojë pakësimi fondi Studime projektive /oponencë teknike në vlerën 8,360,000 lekë .

9. Të miratojë ndryshimet buxhetore në strukturën si më poshtë:

**Pakësim**

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 5	230	8,360,000 lekë Studime projektive /oponencë teknike me kod projekti 1280172.

**Shtesë**

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	4520	0 5	231	1,446,487 TVSH –së për blerje kamion zjarrfikës Librazhd Projekti për Sigurimin e një kamioni zjarrfikës në Librazhd

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 5	231	2,000,000 lekë Mbikqyrje –kolaudime per vitin 2024

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 5	606	500,000 Ndihmë financiare

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	4520	0 5	602	150,000 Shpenzime uje dhe drita

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	10430	0 5	602	200,000 Shpenzime uje dhe drita

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	1110	0 5	602	500,000 Udhetime e dieta

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	4980	0 5	609	3,563.513 Fond reserve

10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori Juridik.

11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

**KRYETARI I BASHKISE  
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 350 Prot.

Librazhd më, 25.07.2024

LËNDA: Kërkesë për bashkëfinancimin e blerjes me objekt: “Blerje kamion zjarrfikës” me grantin e Ambasadës Japoneze në Shqipëri.

DREJTUAR: Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

PËR DIJENI: Kryetari i Bashkisë, Z. Mariglen Disha

Drejtorja e Integrimit European dhe Ndihmës së Huaj aplikoi për grant në ambasadën Japoneze në Shqipëri për blerjen e një kamioni zjarrfikës. Ambasada Japoneze e shpalli Bashkinë Librazhd si përfituese të grantit për blerjen e kamionit zjarrfikës në vlerën 7 232 433 lekë.

Bazuar në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 30 “Transferimet dhe Ndihma Ndërkombëtare”; Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 6, neni 29; udhëzimi nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” TVSH-ja për projektet e financuara nga donatorë të huaj nuk parashikohet gjatë shkrimit dhe miratimit të projektit. Bashkëfinancimi i TVSH-së duhet të bëhet nga institucioni në territorin e të cilit është implementuar projekti.

Drejtorja e Integrimit European dhe Ndihmës së Huaj kërkon financimin e TVSH-së në vlerën 1 446 487 lekë për blerjen me objekt “Blerje kamion zjarrfikës” me grantin e përfituar nga Ambasada Japoneze në Shqipëri.

Duke shpresuar në ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj.

Konc.: M. Dashballa  
Miratoi: A. Kopaçi

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**

P

Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”

Email: [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al)

[www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZH D

RELACION PËR BASHKËFINANCIMIN E BLERJES ME OBJEKT: “BLERJE KAMION ZJARRFIKES“


Drejtoria e Integrimit Europian dhe Ndhmës së Huaj në Bashkinë Librazhd aplikoi në qershor të vitit 2023 për Grant në Ambasadën Japoneze për blerjen e një kamioni zjarrfikës. Pasi u dërgua gjithë dokumentacioni sipas procedurës, Ambasada Japoneze e shpalli Bashkinë Librazhd si përfituese e grantit për “Blerjen e nje kamioni zjarrfikës” në vlerën 7 232 433 lekë.

Bazuar në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 30 “Transferimet dhe Ndhima Ndërkombëtare”; Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 6, neni 29; udhëzimi nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” TVSH-ja për projektet e financuara nga donatorë të huaj nuk parashikohet gjatë shkrimit dhe miratimit të projektit. Bashkëfinancimi i TVSH-së duhet të bëhet nga institucioni në territorin e të cilit është implementuar projekti.

Përfituesit kryesorë nga blerja e kamionit të zjarrfikës janë drejtpërdrejt qytetarët e territorit të Bashkisë Librazhd. Në raste emergjencash që kanë të bëjnë me zjarrfikësen, me blerjen e mjetit të ri, shërbimi do të ofrohet me eficence dhe efektivitet. Gjithashtu edhe për punonjësit e sektorit zjarrfikës pajisja me mjet të ri pune i ndihmon ata në ushtrimin e profesionit të tyre.

Bashkia Librazhd ka në dispozicion fondin e dhënë nga ambasada Japoneze dhe për të vazhduar me procedurën e prokurimit sipas ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duhet të miratojë bashkëfinancimin e T.V.SH-së (20% e vlerës totale te grantit) Për këtë arsye nevojitet bashkëfinancimi i T.V.SH-së nga Bashkia Librazhd për blerjen e kamionit zjarrfikës në vlerën 1 446 487 lekë.

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ  
Alen KOPAÇI



Preventiv

Mirator

Kryetari i Bashkisë

Mariglen DISKALKA

Objekti: Blerje kamion zjarrfikës Librazhd



Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi pa T.V.SH	Vlera (ne leke)
1	Kamion Zjarrfikës	copë	1	7,232,433	7,232,433
	<b>TOTALI</b>				<b>7,232,433</b>
	<b>T.V.SH</b>				<b>1,446,487</b>
	<b>TOTALI ME T.V.SH</b>				<b>8,678,920</b>

## **RELACION**

Titull: Kërkesë për Shtesë Fondesh për Mbikëqyrje dhe Kolaudime të Objekteve të Ndryshme

Nëpërmjet këtij relacioni kërkojmë shtesë fondesh për mbikëqyrje dhe kolaudime në disa projekte të fituara nga bashkia jonë. Mbikëqyrja e kolaudimeve përfshin procesin e monitorimit dhe kontrollit të ndërtimeve dhe projekteve për t'u siguruar që ato përmbushin standardet dhe rregulloret përkatëse. Mbikëqyrja e kolaudimeve është thelbësore për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ndërtimeve, dhe për të siguruar që ato janë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim publik.


Projektet specifike përfshijnë:

- 1. Rikonstrukcion dhe ndërtim i palestrës shkolla e mesme e bashkuar Shefqet Dosku**  
Projekt i fituar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në vlerën 92,224,860 lekë.  
Ndërtimi i një shkolle është një proces i rëndësishëm për komunitetin dhe arsimin në përgjithësi.
- 2. Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara:**  
Projekt i fituar nga Ministria e Kulturës në vlerën 45,665,138 lekë.  
Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara është një nismë e rëndësishme për të përmirësuar jetesën dhe kushtet e banimit për ata që kanë më shumë nevojë, duke kontribuar në rritjen e përgjigjes sociale dhe mbështetjes së qëndrueshme të zhvillimit komunitar.
- 3. Rikonstrukcion i rrugës për te kisha:**  
Projekt i financuar nga Këshilli i Qarkut Elbasan në vlerën 8,398,712 lekë.  
Rikonstrukcioni i një rrugë është një projekt i rëndësishëm për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurinë në transport, është një angazhim i madh që kërkon bashkëpunim të ngushtë mes autoriteteve lokale, inxhinierëve të infrastrukturës, kontraktorëve të ndërtimit dhe komunitetit lokal për të siguruar një rezultat të suksesshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë përdoruesit e rrugës.

Këto projekte janë të rëndësishme për komunitetin tonë dhe përmbushin nevojat specifike të komunitetit .

Gjatë fazës së implementimit, ka rezultuar se kostot për mbikëqyrje dhe kolaudime nuk janë parashikuar në buxhetin fillestar. Kjo shtesë fondesh do të sigurojë që projektet e fituara të përfundojnë me sukses dhe të plotësojnë standardet dhe specifikimet e nevojshme.

Adela Haskurti







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/VENDIM

NR \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/07/2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B NR.3 DATË 30.01.2024 “PER NJE SHTESE NE V.K.B.NR.119 .DATE 29.12.2023“PER MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2024 TE BASHKISE LIBRAZHD DHE PROGRAMIT PERFUNDIMTAR BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.97/2023“Për Buxhetin e vitit 2024”, në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin nr. 22 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhezimi plotesues nr.1 date 24.01.2024 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/07/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë shtesë fondi për shpenzime për aktivitete për vitin 2024 në vlerën 1,200,000 lekë.

2. Të miratojë ndryshimet buxhetore në strukturën si më poshtë:

**Pakësim**

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
00	9120	01	231	1,200,000 lekë Blerje kosha basketbolli per palestren e shkolles se mesme "Ibrahim Muca"Librazhd me kod projekti 1280504

**Shtesë**

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
00	8220	01	602	1,200,000 lekë shpenzime për aktivitete .

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Arsim Kulturës

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

**KRYETARI I BASHKISE**

**MARIGLEN DISHA**

Adresa: Sheshi “ Gjorg Golemi” email: [www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al), [info@bashkialibrazhd.gov](mailto:info@bashkialibrazhd.gov).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
DREJTORIA E ARSIM KULTURËS

## Relacion

Bazuar në kalendarin e aktiviteteve vjetore që Drejtoria e Arsim Kulturës realizon dhe ka të planifikuar në buxhet si dhe krijimit të Drejtorisë së Turizmit që ka për qëllim promovimin e atraksioneve turistike, kërkohet shtim fondi tek shpenzime për aktivitete.

Krijimi i Drejtorisë Së Turizmit pranë Bashkisë, hapi një perspektivë të re krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për vizitorët dhe operatorët që ofrojnë shërbim. Çelja e “ Sezonit Turistik “ për Librazhdin, instaloi për herë të parë festën e turizmit që fton gjithë vizitorët vendas dhe të huaj të shijojnë vlerat natyrore, kuturore dhe bukuritë e rralla natyrore. Duke qënë që Drejtoria e Turizmit nuk ka të planifikuar buxhet për arsye se është krijuar së fundmi, të gjitha promovimet në panairë dhe aktivitetet janë adresuar tek shpenzime për aktivitete.

Kërkohet që planifikimi për objektin “Blerje kosha basketbolli për shkollën “Ibrahim Muça” të shtyhet për vitin 2025 dhe ky fond i planifikuar të kalojë tek “ shpenzime për aktivitete”.

Theksojmë që ky kalim është i nevojshëm për realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuar për periudhën Gusht-Dhjetor.

Duke shpresuar në miratimin e kërkesës sonë,

DREJTORIA ARSIM KULTURËS  
MANJOLA ALLIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/VENDIM

NR \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/07/2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B NR.119 DATË 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 22 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te monitorimit të buxhetit të njëjive të vetëqeverisjes vendore”, Udhezimi plotesues nr.1 date 24.01.2024 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/07/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë financimin për blerje tuba për kanalet vaditëse në vlerën 590,772 lekë.
2. Për sigurimin e këtyre fondeve të miratojë pakësimin e fondit të kursyer nga kontrata “Blerje tuba për kanale vaditëse” në vlerën 356,286 lekë ,dhe kursim fondi nga kontrata “Rikonstruksion kanali Kutërmanit “ në vlerën 234,486 lekë.
3. Të miratojë ndryshimet buxhetore në strukturën si më poshtë:

**Pakësim**

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	4240	0 1	231	356,286 lekë	Blerje tuba për kanalet vaditëse
me kod projekti 1280330					
Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	4240	0 5	231	234,486 lekë	Rikonstruksion kanali
Kutërmanit 1280489					

## Shtesë

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
0 0	4240	0 1	231	356,286 lekë Blerje tuba për kanalet vaditëse
0 0	4240	0 5	231	234,486 lekë

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori Juridik, Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

**KRYETARI I BASHKISE**  
**MARIGLEN DISHA**





BASHKIA LIBRAZHË  
DREJTORIA E BUJQESISE DHE USHQIMIT

Dt.20.06.2024

KERKESE

Per sigurim fondi per blerje tuba, ne kanalet ujites te demtuara nga faktore natyrore gjate muajve te pranveres.

Drejtuar: Sekretarit te Pergjithshem, z. Bajram Pishkashi.

Gjate muajve te fundit, jane verifikuar rreshqitje toke e renie guresh, duke demtuar nje pjese te kanaleve ujites; Per t'i rikthyer ne gjendje funksionale kerkojme qe brenda limitit financiar per blerje tuba, te miratohet fondi per blerje tuba, shtese.  
Bashkengjitur po ju dergojme planinifikimin e nevojave dhe relacionin perkates.

Konceptoi: ing. Bujar Koçi

Miratoi: pergjegjesi, Xhemal Kerçini

DREJTORI

Hysni HOXHA

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Tuba të brinjëzuar për përdorim në kanalizime ujrash të bardha dhe të zeza, drenazhime, mbrojtje, kabllosh elektrike, telekomunikacioni etj., tub të strukturuar prej polietileni me dendësi të lartë me parete të dyfishta sipas standardit pr EN 13476-1 TIPI B sipas të cilit pareti i brendshëm është lisho dhe pareti i jashtëm është i strukturuar. Bashkohen me njëri - tjetrin sipas metodës me një manikotë + 2 guarnicione prej gome. Manikotat janë me parete të jashtëm të strukturuar dhe me një pengesë në mes të saj sipas EN13476-1 2000 dhe gominat prodhohen sipas standardit EN 681, MODEL SN 8. Tubacionet te jene ne gjatesi prej 6 ml.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Gjithashtu dhe specifikimet teknike janë korrekte dhe i pergjigjen kerkesave te sherbimit te kerkuar dhe bazes ligjore ne fuqi per prokurimet.

Persa me siper ky proces-verbal mbahet ne tre kopje.

### **Komisioni**


(Xhemal Kerçini)



(Bujar Koçi)



(Ervis Sejdini)



PLANI I SHPERNDARJES SE TUBAVE PER UJITJE Shtesa per emergjenca 2024

Miratohet  
KRYETARI  
Mariglen Disha

Nr.	Njesia Admin.	Fshati	Madhësia e tubave				Plasmas
			Ø 160	Ø 200	Ø 315	Ø 400	
I	Hotolisht		0	0	60	0	
1		Vehcan-Kobilla			60		
II	Polis		30	24	0		
1		P. Sheh		24		0	
		Mirake	30				
III	Orenje		0	102	72	0	
1		Funares - Lagjia Hida			30		
2		Gurakuq - L. Berxhe			42		
		Floq - fusha		102			
IV	Qender		60	126	102	18	
1		Spathar			6		
2		Togez		12	24		
3		Lib.Kat. Rrina				18	
5		Dorez - Mesi dytesor		114	72		
6		Dragostunje - Balliu	60				
	Shuma		90	252	234	18	0
	PLANI						0

Hartuan planin

Inxhinieri  
Bujar Koci




Pergjegjesi  
Xhemal Kerçini



Miratoi

Drejtori  
Hysni Hoxha





BASHKIA LIBRAZH  
DREJTORIA E BUJQESISE DHE USHQIMIT  
SEKTORI I UJITJE E FERMAVE

Miratohet  
Kryetari i Bashkise  
~~Mariglen DISHA~~



PROÇES-VERBAL  
Per përlogaritjen e vlerës limit ,specifikimeve teknike  
Blerje tuba per kanalet vaditese

I mbajtur sot me date **21 /06/2024** ne ambientet e Bashkise Librazhd, ne prani te komisionit te perlllogaritjes se fondit per blerje tuba shtese per nevoja emergjente.

Komisioni duke marre parasysh kerkesat per nje cilesi sa me te larte hartoi preventivin si me poshte:

Bazuar ne Portalin Analiza e Çmimeve te platformes **e-albania (Hartimi i preventivave nga manuali I çmimeve te materialeve te ndertimit te vitit 2023 ) Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998** "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar me - **VKM nr. 216, datë 13.04.2023** "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve" - **Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003** "Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, komisioni vendosi çmimet e blerjes dhe specifikimrt teknike te tubave per kanalet ujites si me poshte:

Nr.	Emertimi i artikullit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Tube e brinjezuar HDPE SN8 Ø=160 mm	ml	90	460	41 400
4	Rakorderi	cope	7	50	350
5	Tube e brinjezuar HDPE SN8 Ø=200mm	ml	252	600	151 200
6	Rakorderi	cope	20	60	1 200
7	Tube e brinjezuar HDPE SN8 Ø=315 mm	ml	234	1100	257 400
8	Rakorderi	cope	20	88	1 760
9	Tube e brinjezuar HDPE SN8 Ø=400 mm	ml	18	2150	38700
10	Rakorderi	cope	2	150	300
	<b>TOTALE PA TVSH</b>				<b>492 310</b>
	<b>TVSH</b>				<b>98 462</b>
	<b>TOTALE ME TVSH</b>				<b>590 772</b>

Nisur nga fondi i parashikuar ne buxhet per keto sherbime, komisioni konkludoi se vlera e fondit limit per zerin buxhetor Blerje tuba per kanalet vaditese eshte **492 310 (Katerqint e nentedhete e dy mije e treqint e dhjete) leke pa tvsh dhe 590772(pesqint e nentedhete mije e shtateqint e shtatedhete e dy) leke me Tvsh.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

P/ VENDIM  
NR \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/07/2024

Për miratimin e investimit me objekt “Ndërtim i pritës lumore, argjinaturës në zallin Shmil”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.97/2023“Për Buxhetin e vitit 2024”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”, VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik” në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 22 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhezimi plotësues nr.1 date 24.01.2024 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/07/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

**VENDOSI :**

1. Të miratojë investimin për objektin “Ndërtim i pritës lumore, argjinaturës në zallin Shmil”, sipas projekt-propozimit vlera e investimit shkon rreth 135 000 000 lekë.
2. Bazuar në kërkesën e subjektit “Erdy Energy” shpk që ushtron aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike i cili kërkon që të realizojë në formën e donacionit privat pa asnjë pagesë nga buxheti i bashkisë Librazhd investimin e ndërtimit të pritës lumore që do të shërbejë komunitetit në atë zonë dhe subjektin do ta mbrojë për aktivitetin që ushtron.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urabnistikës dhe Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Bujqësisë, Vetëqeverisjes dhe Ujitjes, Sektori Aseteve, Njësia Administrative Qendër .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**

Adresa: Sheshi “ Gjorg Golemi” email: [www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al), [info@bashkialibrazhd.gov](mailto:info@bashkialibrazhd.gov).

## Relacion mbi projekt-vendimin

Bashkia Librazhd ka marrë në konsideratë kërkesën që ka shprehur interes subjekti "Erđy Energy" shpk për ndërtimin e pritës lumore, argjinaturës në zallin Shmil. Financimi i këtij projekti është mjaft I rëndësishëm si investim për mbrojtjen lumore por edhe për banorët që preken. Investimi do të ndikojë në mbrojtjen e fondi pyjor e kullosor nga erozioni por edhe të tokave bujqësore të banorëve.

Bashkëngjitur këtij projekt vendimi është harta treguese në të cilën do të ndërhyhet për ndërtimin e pritës lumore.

Subjekti "Erđy Energy" shpk ka aktualisht kontratë qiraje me bashkinë Librazhd si më poshtë :

1. Kontratë qiraje Nr. 2470 Prot datë 15.05.2018: Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor " për ushtrimin e aktivitetit Hec
2. Kontratë qirje Nr.4691 prot datë 26.10.2020. : Për dhënie në përdorim të gjtësisë së linjës elektrike që përdor
3. Kontratë qiraje : "Për marrjen në përdorim të trullit që ka ndërtuar godinën e Hec-it" sipërfaqe kjo e hequr ng fondi pyjor.

Vlen të theksojmë se subjekti ka bërë ndërhyrje të herëpashershme në mirëmbatjeën e infrastrukturës rrugore të fshatrave ku ushtron veprimtrainë e prodhimit të energjisë por dhe në kanale vaditëse.

Investimi që subjekti kërkon të kryej është një investim shumë I rëndësishëm sa i përket mbrojtjeve të tokave bujqësore dhe fondit pyjor e kullosor që vitet e fundit erozioni ka shkaktuar dëme duke i kaluar tokat në toka joprodhuese.

P/Drejtoria e Urabnistikës dhe Planifikimit të Territorit  
P/Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave  
P/Drejtoria e Bujqësisë, Vetënarisë dhe Ujitjes  
P/Spektori Aseteve  
P/Njësia Administrative Qendër

z. Klodian Burgja  
z. Aleksander Brazhda  
z. Hysni Hoxha  
z. Dorian Hasula  
z. Roland Çota





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD

P/VENDIM

Nr \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2024

“PËR MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS AUTO ME GJATËSI 1 KM TË LAGJIES ALCANI  
FSHATI MEXIXË”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, neni 16 pika 2 dhe neni 22 pika 1, Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive” i ndryshuar, kërkesës së bërë nga banorët e lagjes Alcani fshati Mexixë drejtuar bashkisë Librazhd, pasi dëgjoji përfaqësuesit e bashkisë :

VENDOSI:

1. Të miratojë me shkrim vazhdimin e procedurave për hapjen e 1 km trase rruge të re të lagjies Alcani në fshatin Mexixë për ta lidhur me rrugën kryesore.
2. Proçedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Urbanistika për projektimin e rrugës dhe nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të bashkisë Librazhd për llogaritje të volumit drusor nëse do të ketë meqënëse rruga kalon në afërsi të pyllit .
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KONCEPTOI  
P/Drejtorinë e Urbanistikës  
Drejtori  
Klodian Burgjia

P/Drejtorinë e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave  
Drejtori  
Aleksandër Brazhda

KRYETARI  
Mariglen DISHA

## RELACION

### “PËR MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS AUTO ”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,të ligjit 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet” , neni 16 pika 2 dhe neni 22 pika 1 , Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive” i ndryshuar, dhe kërkesës së bërë nga banorët e lagjes Alcani po hartohet ky relacion në mbështetje të projekt – vendimit.

Banorët e lagjes Alcani kanë të nevojshme për një rrugë me gjatës rreth 1 km të re për ta lidhur me rrugën egzistuese. Hapja e këtij segmenti dhe lidhja me rrugën ekzistuese auto do të bëj të mundur që lagjia Alcani të mos ketë probleme të rrugës por gjithashtu gjurma e cila do të kalojë rruga është më e favorshme duke eliminuar pjerrësinë,gërryrjen e cila prishet gjatë reshjeve.

Kjo rrugë do të na ndihmojë që të arrihet mbritshmëria në pyje ,ku në këtë mënyrë bëhet mbrojtja më e mirë e pyjeve ndaj zjarreve,

Nga verifikimi në vënd ju sqarojmë se kjo rrugë kalon vetëm në fond pyjor dhe nuk prek tokat bujqësore si dhe nuk ka konflikte apo kundërshtime për këtë rrugë.

Ky investim do të realizohet nga vetë banorët lagjes.

Në mungesë të lidhjes së lagjies Alcani me rrugën kryesore të fshatit i kërkojmë këshillit bashkiak që të miratojë hapjen e trases së re të rrugës auto **me gjatësi 1 km në mënyrë që Urbanistika dhe Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Librazhd të ndjekin procedurat e mëtejshme.**

Bashkëngjitur këtij projekt vendimi harta që tregon gjurmën e rrugës.

**P/Drejtorinë e Urbanistikës P/Drejtorinë e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Drejtori

Klodian Burgjia

Drejtori

Aleksandër Brazhda

437600 437800 438000 438200 438400 438600 438800

**PLANVENDOSJE**  
**SEGMENTI RRUGORE FSHATI NESHTE (LAGJIA ALCANI)**  
**(Fragment Harte Pyjore)**  
**Ekozonja Pyjore Cermenike**  
**Ngastrat qe pershifhen ne segmentin e ri qe do hapet**  
**(45a, 45b, 46b, 55c)**



4574200  
4573900  
4573600  
4573300  
4573000  
4572700

4574200  
4573900  
4573600  
4573300  
4573000  
4572700




1:5,000

**Legjenda:**

-  Rruge auto Ekzistuese rreth 1480 ml
-  Rruga e re qe do hapet rreth 1000 ml

Source: Esri, Maxar, Earthstar Geographics, and the GIS User Community

437600 437800 438000 438200 438400 438600 438800



437600 437800 438000 438200 438400 438600 438800

**PLANVENDOSJE  
SEGMENTI RRUGORE FSHATI NË SHTE (LAGJIA ALCANI)  
(Fragment Hartë Qrtofoto)**





1:5,000



4574200  
4573900  
4573600  
4573300  
4573000  
4572700

4574200  
4573900  
4573600  
4573300  
4573000  
4572700

**Legjenda:**

-  Rruge auto Ekzistuese rreth 1480 ml
-  Rruga e re qe do hapet rreth 1000 ml

437600 437800 438000 438200 438400 438600 438800



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**KRYETARI**

**PROJEKT-VENDIM**

Nr \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**“PËR MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESËS SË ZNJ. FATIME BRAHJA”**

*Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetë Qeverisjen Vendore”, ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”, VKM-së nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, i paarashtrijmë për miratim Këshillit Bashkika në mbledhjen e datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024,*

**TË VENDOSI:**

1. Të përfundojë procesi i privatizimit për banesën e Znj. Fatime Brahja (trashëgimtarët).
2. Dosja e privatizimit të administrohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim pranë Bashkisë Librazhd, pasi të jetë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm origjinal të privatizimit (ose të njehsuar me origjinalin).
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë/personi i autorizuar prej tij, Komisioni i Privatizimit dhe Sektori Juridik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**

~~MARIGLEN DISHA~~

~~P~~





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**RELACION  
PËR PROJEKT-VENDIMIN**

**“Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesës së Znj. Fatime Brahja (Trashëgimtarët)”**

*Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetë Qeverisjen Vendore”, ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”, VKM-së nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, I parashtrojmë Këshillit Bashkiak se:*

Nisur nga kërkesa e Z. Ylli Brahja, trashëgimtar i znj. Fatime Brahja, drejtuar ASHK Drejtorisë Vendore Librazhd për regjistrim trualli, të blerë sipas mandat arkëtimit Nr 788, datë 26.8.1993 po nisim procedurat për privatizimin e banesës së kësaj shtetase, e cila e ka disponuar dhe banuar këtë banesë për më shumë se 50 vjet.


Në dokumentacionin e administruar, gjenden këto dokumente sipas kronologjisë si më poshtë:

1. Kërkesa e Z. Ylli Brahja;
2. Plan rilevimi;
3. Planimetri e katit përdhe;
4. Kopje e planit të vendosjes;
5. Kopje e Formularit Nr. 2, datë 26.08.1993;
6. Kopje e kërkesës së Znj. Fatime Brahja datë 5.4.1993;
7. Kopje e çertifikatës familjare;
8. Kopje e mandat pagesës Nr 788, datë 26.8.1993 me vlerë 3339 lekë;

Për sa më sipër, komisioni pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe administruar pranë Bashkisë Librazhd, arsyetoi se:

Në bazë të VKM-së nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa

me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, kërkojmë të formalizohet kontrata, duke dhënë miratimin Këshilli Bashkiak si organi kompetent dhe vendimarrës, dhe lidhja e kontratës sipas formës së kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping horizontal strokes and a diagonal stroke crossing them from the top left to the bottom right.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**KRYETARI**

**PROJEKT/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**Propozim për dhënien me qira të pasurisë shtetërore**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Urdhërit të Kryetarit Nr.112, date 17.02.2017 “Për krijimin e komisionit të dhënies me qira të pasurive shtetërore “, të ndryshuar, bazuar në kompetencat që na jep ligji, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, i propozohet për miratim Këshillit Bashkiak , në mbledhjen e datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024,

**TË VENDOSI :**

1.Miratimin e dhënies me qira të një sipërfaqeje totale prej 500 m<sup>2</sup>, nga sa 300m<sup>2</sup> është ambjenti funksional, nga pasuria shtetërore e ndodhur në Zonën Kadastrale 2696, me afat 10 vjeçar, me veprimtari aktivitet tregtar, sipas genplanit bashkëngjitur.

2. Tarifa dysHEME i detyrimit mujor për truallin e lirë të jetë 100 lekë/m<sup>2</sup> në muaj.

3.Kryerjen e vleresimit për konkurrentët në pikë për cdo element konkurrimi si më poshtë;

nivelin e investimit	15 pikë
nivelin e punësimit	15 pikë
ofertën e detyrimit mujor të qirasë	60 pikë
ofrimin e shërbimeve për komunitetin	10 pikë

4. Informimin e titullarit të institucionit për zhvillimin e konkurrimit, së bashku me proces-verbalin e konkurrimit dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

5. Autorizimin e kryetarit të bashkisë për të kryer procedurat përkatëse të parashikuara në ligj për kryerjen e procedurës së konkurrimit në buletinin e njoftimeve publike deri në nëshkrimin e kontratës së qirasë.

6. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Komisioni i dhënies me qira të pasurive shtetërore.

7.Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISE**  
**MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI  
RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN

“Propozim për dhënien me qira të pasurisë shtetërore”

Ky raport paraqet rezultatet e vlerësimit të projektit “Jo Droga! Food Hub - Një alternativë e zhvillimit të qëndrueshëm për të rinjtë dhe komunitetet në Librazhd” e cila u financua nga një kontratë granti nga Thirrja për Propozim të Programit IPA 2018 të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, me numër referencë granti 2021/425-798. Projekti filloi zbatimin më 01 tetor 2021 për një periudhë zbatimi prej 28 muajsh dhe ka përfunduar më 31 Janar 2024 sipas kontratës së grantit.

Nga kjo analizë rezulton se projekti “Jo Droga! Food Hub - Një alternativë e zhvillimit të qëndrueshëm për të rinjtë dhe komunitetet në Librazhd”, është e rëndësishme për kontekstin e Bashkisë Librazhd dhe është plotësisht në përputhje me kuadrin strategjik të BE-së dhe angazhimet e vendit si dhe me axhendën globale të zhvillimit dhe politikën e brendshme lidhur me zhvillimin dhe promovimin e produkteve turistike, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm bazuar në përdorimin e kujdesshëm të burimeve natyrore.

Kjo veper ndodhet 2.5 km nga Qyteti i Librazhdit ,vendi i quajtur “ Kthesa E Murracit” ,ish bazat ushtarake te Ministrise se Mbrojtjes.Ambjenti funksional per qellimin e grumbullimit te produkteve bujqesore dhe blegtorale ka nje siperfaqe 300 m2. Brenda kesaj siperfaqe jane instaluar 50 m2 dhoma frigoriferike per ruatjen e produkteve me standarte bashkohore. Gjithashtu eshte miratuar nga Ministria e financave marka e Food Hub dhe certifikimi i 5 produkteve lokale : Arra, Geshtenja,Lajthia, Patate dhe Mjalti.

Gjate shkrimit te projektit ishte parashikur edhe Qendrueshmeria e vepres Food Hub ( Pike Grumbullimi). Per rrjedhoje eshte bere nje analize me eksperte te fushes lidhur me menaxhimin. Ekspertet ne bashkepunim me Bashkine dhe partneret lokale vendosen qe menaxhimi te ishte me sipermarres private. Kjo per arsye se Bashkia nuk ka eksperience menaxhimi te sipermarrjeve te medha me interes fitimin . Per fillimin e veprimtarise se Food Hub u propozuan 2 alternativa:

- 1- Dhënia qera me sipermarrje private individ.**
- 2- Dhënie me qera organizate lokale me fokus zhvillimin e konomik.**

Alternativa me menaxhim privat u mendua si praktike e suksesshme pasi garanton qendrueshmerine e ketij aktiviteti . Per te siguruar ecurine korrekte nga sipermarresi lidhur me marredhenien me fermeret do te krijohet nje bord mbikqyres nga Bashkia . Bordi ka ne perberje perfaqesues nga grupet e interesit ( perfaqesues nga Bashkia,fermeret,biznesi ) ,i cili do

marredhenien me fermeret do te krijohet nje bord mbikqyres nga Bashkia . Bordi ka ne perberje perfaqesues nga grupet e interesit ( perfaqesues nga Bashkia,fermeret,biznesi ) ,i cili do monitoroje ne cdo kohe marredhenien e sipermarresit me fermeret. Qellimi i madh eshte qe fermeret sigurojne shitjen e produkteve dhe zgjerimin e bizneseve . Sipermarresi bazuar ne kushtet aktuale te tregut garanton kontroll te cilesise dhe siguri ushqimore per konsumatorin.

Detaje te tjera teknike ,perdorimi,sigurie rregullohen me marreveshje noteriale te firmosur nga palet.

